



A.nr.229/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.229/2026, të datës 03.03.2026, të parashtruar nga ankuesja D.B. nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridiko-administrative “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin, 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.229/2026, e datës 03.03.2025, e parashtruar nga ankuesja D.B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile D.B. (*referuar tutje vetëm ankuesja*), më datë 03.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit Komunës së Prishtinës lidhur nivelin e koeficientit të pagës duke pretenduar se nuk paguhet sipas pagës sikurse kolegët tjerë të Qendrës për Punë Sociale Njësia 1, edhe pse ushtrijmë detyrat e njëjta mirëpo koeficienti i pagës është i ndryshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 16.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, ***është e palejuar, sepse:***

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ankuesja sipas Akt Emërimit Nr.14012.01-373323, të datës 16.11.2024, mban pozitën *Zyrtare për Mirëqenie Sociale*, në Qendrën për Punë Sociale Njësia 1, në Komunën e Prishtinës.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk paguhet sipas pagës sikurse kolegët tjerë të Qendrës për Punës Sociale Njësia 1, edhe pse ushtrijmë detyrat e njëjta mirëpo koeficienti i pagës është i ndryshëm. Kërkon që të rishikohet koeficienti i pagës, harmonizohet me koeficientin e koleges dhe të zbatohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë sipas legjislacionit në fuqi.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushemrisë së ankesës ju referua nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, ku është përcaktuar: *“3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil”*, si dhe nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrijë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,..”* dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor rezulton fakti se nëpunësi civil në çdo rast kur pretendon se me veprimin apo mosveprimin e organit përkatës i janë shkelur apo cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, i njëjti posedon të drejtën e parashtrimit të ankesës në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si organ i vetëm kompetent për shqyrtimin e ankesave, mirëpo, duke qenë se ankuesja pretendon në trajtimin jo të barabartë të koeficientit për punë të njëjtë me kolegët tjerë, sipas provave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, nuk rezulton se ankuesja fillimisht të ketë ndërmarr ndonjë veprim që të drejtën e saj të pretenduar të kërkoj pranë organit të punësimit si organ ku e njëjta ka të themeluar marrëdhënien e punës, e mbi këtë konstatim Kolegji, thekson se ankuesja fillimisht duhet të parashtrojë kërkesë pranë institucionit punëdhënës respektivisht tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, e me pastaj ndaj veprimit (akti administrativ) apo mos veprimit (heshtjes administrative) të organit përkatës/njesisë përkatëse, në pajtim me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të së drejtës në mbrojtje juridike të të drejtave nga marrëdhënia e punës, si një nga të drejtat themelore të garantuara me kushtetutë dhe ligj, Kolegji rithekson faktin së hedhja poshtë e ankesës A.nr.229/2026, nuk nënkupton vendosjen në mënyrë meritore lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore, pasi që siç u tha me sipër, ankuesja zotëron të drejtën që të ndërmarr verimet për fillimin e procedurës administrative pranë organit punëdhënës, e me pastaj të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.229/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses D.B.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;